



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 167 dt.26.08.1994

PER
DISA NDRYSHIME NE STRUKTUREN E APARATIT
TE BASHKISE SE TIRANES

Këshilli i Bashkisë së Tiranës, në mbledhjen e kësaj date, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Z. Sali Kelmendi “Për disa ndryshime në strukturën e aparatit administrativ të Bashkisë Tiranë”, mbështetur në pikën.4 të nenit.14 të Ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin e funksionimin e pushtetit lokal”,

VENDOSI

Në aparatin Administrativ të Bashkisë së Tiranës të bëhen këto ndryshime :

1. Në përbërjen e Drejtorisë së Studimit, Projektimit dhe të Kontrollit të Punës Urbane, të krijohet “Protokoll – Arkiva dhe Juristi”.
2. Në përbërjen e Drejtorisë së Shërbimeve Rregullimeve e Ndërtimeve Publike të krijohet “Sektori Ujësjellësit”, burimeve ujore, rrugë – kanalizime dhe pastrim gjelbërimit.

3. Në vend të Zyrës së Gjendjes Civile të krijohet Seksioni i Gjendjes Civile.
4. Të krijohet Zyra e Informacionit dhe e shtypit.
5. “Seksioni i Prognozës, politikës ekonomike dhe statistikës” të emërtohet “Seksioni i Prognozimit, politikës ekonomike dhe statistikës lokale”.
6. Të krijohet vendi i “Këshilltarit të kryetarit të Bashkisë për sistemin fiskal”.
7. Të suprimohet Seksioni i Strehim – Leje Banimit.
8. Detyrat që i lindin Bashkisë për problemet e strehimit do t’i mbulojë Drejtoria e Shërbimeve Komunale të kësaj Bashkie.

KRYETARI

BESNIK PETRELA